



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2020
Nr. Dok. 202002676/6

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e shtetasit A. H. me certifikatën e punonjësit të shërbimit.*

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË SHTETIT
Drejtues Madhor Ardi Veliu
Tiranë

Për dijeni : Z. A. H.
Email: almirhasanaj123@yahoo.com

I nderuar zoti Veliu,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi A. H.. Ankuesi shkruan se në muajin qershor 2020 ka aplikuar në Drejtorinë Vendore të Policisë (DVP) Fier për t'u pajisur me certifikatën e punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike. Por kërkesa e tij me vendimin nr. 153, datë 22.06.2020 të Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave të DVP Fier është refuzuar me arsyetimin se nuk plotëson kriteret ligjore.

Ankuesi pretendon se refuzimi i kërkesës së tij për t'u pajisur me certifikatën e punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike është bërë në mënyrë të padrejtë sepse ai nuk ka asnjë pengesë ligjore për t'u pajisur me këtë certifikatë.

Gjithashtu ai shkruan se para 5 vitesh është dënuar me gjobë nga Gjykata e Shkallës së Parë Fier, por ky dënim është amnistuar dhe se ai e ka marrë të pastër vërtetimin e gjendjes gjyqësore, të cilin e ka depozituar së bashku me aplikimin.

Në bazë të kërkesës tonë, Drejtoria Vendore e Policisë (DVP) Fier me shkresën nr. 8026/1 prot., datë 18.09.2020 ndërmjet të tjerave na informoi se shtetasi A. H. ka aplikuar pranë Zyrës së Shërbimit të Qytetarëve në Komisaratin e Policisë Mallakastër për certifikim si punonjës shërbimi në SHPSF në datën 04.06.2020. Dokumentacioni i aplikimit të tij ka ardhur në DVP Fier pranë Sektorit të Rendit dhe Policimit në Komunitet në datën 08.06.2020.

Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim pranë DVP Fier, i mbledhur në datën 22.06.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin vendosi refuzimin e pajisjes së shtetasit A. H. me certifikatë për ushtrimin e profesionit si punonjës shërbimi pasi nuk plotëson kriteret për t'u certifikuar si i tillë në zbatim të ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike", neni 12, pika "e" (të mos ketë qënë i dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale), sepse me vendimin nr. 187, datë 02.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ai është deklaruar fajtor për veprën penale "Mos bindje ndaj punonjësit të policisë të rendit publik" dhe është dënuar me 50,000 lekë gjobë.

Në këtë përgjigje u informuam se DVP Fier me shkresën nr. 1310, datë 29.06.2020 i ka dërguar Komisarariatit të Policisë Mallakastër njoftimin dhe vendimin nr. 153, datë 22.06.2020 me të cilin shtetasit A. H. i është refuzuar certifikimi si punonjës shërbimi, për ta vënë në dijeni për rrugën që duhet të ndjekë nëse nuk do të ishte dakord me këtë vendim.

Gjithashtu DVP Fier na informoi se ankuesi është njohur me këtë vendim dhe nuk ka bërë ankim në rrugë administrative duke bërë fillimisht ankesë në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave në DVP Fier.

Nga ankesa dhe dokumentacioni i paraqitur në institucionin tonë nga shtetasi A. H., si dhe përgjigjja e dërguar nga DVP Fier, rezulton se ankuesi me vendimin nr. 187, datë 02.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është deklaruar fajtor për veprën penale "Mos bindja ndaj punonjësit të policisë të rendit publik" dhe është dënuar me 50,000 lekë gjobë.

Ndërkohë nga "Vërtetimi i Gjendjes Gjyqësore" së tij, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në datën 04.05.2020, të cilën ai e ka depozituar në DVP Fier dhe një fotokopje të saj e ka dërguar në institucionin tonë së bashku me ankesën rezulton se, **ai është me statusin i padënuar**. Dhënia e vërtetimit shtetasit A. H. me këtë status është bërë për arsye të përfitimit të tij nga instituti juridik i rehabilitimit të parashikuar në nenin 69/a të Kodit Penal ku përcaktohet se:

"Quhen të padënuar:

a) ata që janë dënuar me burgim për një kohë gjer në gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;"

Në zbatim të kësaj dispozite ligjore dhe duke qënë se shtetasi A. H. është dënuar me gjobë, dënim i cili është më i lehtë se dënimi penal gjer në gjashtë muaj burgim, në momentin e aplikimit për pajisjen me certifikatën e punonjësit të shërbimit dhe çka është më e rëndësishme, në datën e shqyrtimit të kërkesës së tij, më 22.06.2020, nga Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim në DVP Fier, **ankuesi konsiderohet i pa dënuar**.

Gjithashtu konstatojmë se, ai ka kryer me sukses edhe kursin "Tekniko-Profesional dhe Fizik" në Qendrën e Trajnimit Privat "Kondi" Shpk dhe është pajisur me "Dëshmi Aftësie" nr. 6 prot., datë 05.06.2020, trajtim i parashikuar në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 505, datë 26.10.2018 "Për Qendrat e Trajnimit Privat".

Ndodhur në këto rrethana, ne vlerësuam se shtetasi A. H. nuk ka pengesa ligjore për t'u pajisur me certifikatën e punonjësit të shërbimit. Mosdhënia e certifikatës së punonjësit të

shërbimit me justifikimin se shtetasi A. H. nuk plotëson kriteret për t'u certifikuar si i tillë në zbatim të ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike", neni 12, pika 1, gërma "e" (të mos ketë qënë i dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale), jo vetëm që nuk është e bazuar dhe në përputhje me ligjin nr. 75/2014 neni 12, pika 1 ku janë parashikuar kriteret për certifikimin e punonjësit të shërbimit, por është në kundërshtim të plotë dhe të hapur me të.

Për këto arsye vlerësuam se akti administrativ, vendimi nr. 153, datë 22.06.2020 i Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim pranë DVP Fier, i nxjerrë ndaj ankuesit është akt i paligjshëm në kuptim të parashikimeve të nenit 109 të K.Pr.A.¹

Për rrjedhojë nga akti administrativ i cituar më sipër atij i është shkelur një e drejtë ligjore e parashikuar në ligjin nr. 75/2014.

Për sa më sipër dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtës ligjore të shkelur shtetasit A. H. , bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*" dhe në gërmën "b" të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: "*Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;*", me shkresën nr. K2/A28-4 prot., datë 09.11.2020 drejtuar DVP Fier i rekomanduam si më poshtë:

"1. Konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ, vendimit nr. 153, datë 22.06.2020, të Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim pranë DVP Fier, si i nxjerrë në kundërshtim me ligjin material.

2. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e shtetasit A. H. me certifikatën e punonjësit të shërbimit në Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".

DVP Fier me shkresën nr. 9897/1 prot., datë 02.12.2020 ndërmjet të tjerave na informoi se, Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim pranë DVP Fier, i mbledhur në datën 22.06.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin vendosi refuzimin e pajisjes së shtetasit A. H. me certifikatë për ushtrimin e profesionit si punonjës shërbimi pasi nuk plotëson një ndër kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike", neni 12, pika "e" (të mos ketë qënë i dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale).

¹ Neni 109 "Paligjshmëria e aktit administrativ"

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;*
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;*
- c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;*
- ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;*
- d) është në kundërshtim me ligjin material;*
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo*
- e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.*

Shtetasi A. H. me vendimin nr. 187, datë 02.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është deklaruar fajtor për veprën penale “Mos bindje ndaj punonjësit të policisë të rendit publik”.

Referuar nenit 27/c të ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, punonjësi i shërbimit privat të sigurisë fizike ka të drejtë të mbajë armatim personal gjatë kryerjes së detyrës. Në ligjin nr. 74/2014 “Për armët” në nenin 25/a parashikohet e drejta e pajisjes me autorizim për blerje arme të kategorisë “B1”, “B4” dhe “C” në përputhje me përcaktimit e këtij ligji të subjekteve të licensuara për shërbimin e sigurisë private. Ndërsa në nenin 34 “Kriteret për t’u pajisur me autorizim” të këtij ligji parashikohet se:

“1. Personi që është përfitues i një prej llojeve të autorizimeve, sipas parashikimeve të këtij ligji, duhet të plotësojë këto kritere:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë mbushur moshën 25 vjeç;

c) të mos ketë qenë i dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje;

ç) të mos ketë qenë i evidentuar për raste të kundërshtimit me dhunë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, nëpunësit publik ose për veprat penale të dhunës në familje, për çështje me objekt të hakmarrjes ose gjakmarrjes;”

Në vijim të përgjigjes së dërguar DVP Fier shprehet se, në interpretim të dispozitave të dy ligjeve të cituar më sipër, të cilat normojnë dhe rregullojnë punën e punonjësve të shërbimit privat të sigurisë fizike, organi administrativ, Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim vendosi refuzimin e licensimit”.

Sikurse rezulton nga përgjigjia e dërguar nga DVP Fier, rekomandimi i bërë nga institucioni ynë është refuzuar. Por refuzimi i tij është bërë si rrjedhojë e interpretimit jo korrekt të dispozitave ligjore të cilave ky organ i është referuar sepse:

a) Sikurse kemi parashtruar edhe më sipër, në referim të nenit 69/a të Kodit Penal shtetasi A. H. konsiderohet i pa dënuar.

b) Në nenin 34/1/ç të ligjit nr. 74/2014 “Për armët” parashikohet që, *personi që është përfitues i një prej llojeve të autorizimeve të mos ketë qenë i evidentuar për raste të kundërshtimit me dhunë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, nëpunësit publik ose për veprat penale të dhunës në familje, për çështje me objekt të hakmarrjes ose gjakmarrjes;”.*

Por, nga të dyja përgjigjet e dërguara institucionit tonë nga DVP Fier, shtetasi A. H. nuk ka qenë i evidentuar për asnjë nga rastet dhe veprat penale të cituara më sipër, por ka qenë i dënuar vetëm për kundërvajtjen penale “Mosbindja ndaj urdhrin të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242² i Kodit Penal. Vepra penale “Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik”, është parashikuar nga neni 235³ i Kodit Penal, ndërsa vepra penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së

² Neni 242 “Mosbindja ndaj urdhrin të punonjësit të policisë së rendit publik”

Mosbindja ndaj urdhrave të ligjshme të punonjësit të policisë së rendit publik përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

³ Neni 235 “Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik”

rendit publik” është parashikuar nga neni 236⁴ i Kodit Penal. Pra kemi të bëjmë me figura të ndryshme të veprave penale.

Theksojmë se, **dënimi i një personi për kryerjen e kundërvajtjes penale “Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik” nuk përbën kriter ndalues sipas nenit 34/1/ç të ligjit nr. 74/2014 “Për armët” për të qënë përfitues i një prej llojeve të autorizimeve për pajisjen e tij me armë sikurse parashtron DVP Fier.**

Ndërkohë nga përgjigjja e fundit dërguar institucionit tonë nga DVP Fier rezulton se strukturat e këtij organi nuk kanë dalë me një akt administrativ të ri lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për certifikimin për ushtrimin e profesionit si punonjës shërbimi. Ne vlerësojmë se nga organi kompetent i DVP Fier pas bërjes së rekomandimit tonë duhet të ishte nxjerrë një akt administrativ, i cili në bazë të nenit 100 të Kodit të Procedurës Civile duhet të jetë i arsyetuar. Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe të përmbajë:

- a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;
- b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;
- c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;
- ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.

Kjo duhet bërë për t’i dhënë mundësi palës për të bërë ankim për shkakun e refuzimit. Vetëm kështu ushtrohet në mënyrë efektive mbrojtja e qytetarit nga veprimet e administratës publike në përgjithësi dhe e Policisë së Shtetit në veçanti.

Meqënëse DVP Fier nuk e pranoi rekomandimin tonë, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në gërmën “c” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen, si dhe në nenet 109/d dhe 113⁵ të Kodit të Procedurës Administrative;

REKOMANDOJMË :

Kundërshtimi që i bëhet një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, me qëllim për ta penguar atë për të kryer detyrën apo shërbimin sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

⁴ Neni 236 “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”

Kundërshtimi që i bëhet punonjësit të policisë së rendit publik, me qëllim për ta penguar atë për të kryer detyrën sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

⁵ Neni 113 “Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit”

1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.
2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.
3. Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.

“1. Marrjen e masave të nevojshme me cilësinë e organit epror të DVP Fier për shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 153, datë 22.06.2020, të Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim pranë DVP Fier, për shkak se është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material.

2. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen nga DVP Fier të shtetasit A. H. me certifikatën e punonjësit të shërbimit në Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Konceptoi: S. Nushi